



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:11026
Datë: 02.04.2021
Numri i dokumentit: 0166294

C.nr.212/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Beshtica dhe bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen juridike të paditëses K... me seli në Bulevardin “”, nr., Prishtinë, kundër të paditurit B. (F.) N., nga Gjilani, rr.””, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 269.43 €, jashtë seance gjyqësore, më datën 02.04.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (K...) me seli në Bulevardin “”, nr. , Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri B. (F.) N., nga Gjilani, rr.””, që paditëses t’ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 269.43 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë me 04.11.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 1 ditës, nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditëses K... me seli në Bulevardin “”, nr., Prishtinë, lidhur me detyrimin e të paditurit B. (F.) N., nga Gjilani, rr.””, për pagesën e shpenzimeve të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja K... me seli në Bulevardin “”, nr., në këtë gjykatë, më datë 04.11.2020, ka dorëzuar padi kundër të paditurit B. (F.) N., nga Gjilani, rr.””, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, me vlerë të objektit 269.43 €, duke theksuar se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.6/16 të datës 2.10.2017, i cili ka marrë formë të prerë me datë 13.11.2017 dhe e dëmtuara (tani paditësja) është udhëzuar në kontest civil për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën penale të lartëcekur. Më tutje ka cekur se nga ana e punëtorëve të autorizuar të paditëses ishte konstatuar se i padituri në shtëpinë e tij me qëllim që vetes ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë

elektrike në mënyrë të paautorizuar, ka lidhur direkt dy kablla, njëfazore dhe njëmonofaze dhe ka bërë shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike dhe me veprimin e tij i ka shkaktuar paditëses dëm material në vlerë prej 269.43 €, andaj meqenëse i padituri me kohë është njoftuar për dëmin që ia ka shkaktuar paditëses, mirëpo i njejtë këtë dëm material nuk e ka kompensuar, e as që ka dhënë sinjale se të njejtën do ta përmbush në procedurë të rregullt, paditësja i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e saj ta aprovoj në tërësi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që paditëses t'ia paguajë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 269.43 €, e më decidivisht si në këtë padi.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë në bazë të nenit 387 par.1, pika (a), ka nxjerrë Aktvendimin C.nr.212 /20, të dt. 2.02.2021, për përgjigje në padi, e të cilin vendim i padituri së bashku me të gjitha shkresat e lëndës e ka pranuar me dt.03.03.2021, fakt ky i vërtetuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjtë nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor dhe as pas kalimit të tij.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 10 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim: LPK) ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, pasi që sipas dispozitës së nenit të cekur më lartë, përkatësisht parag. 1, pikat a), b) dhe c) e këtij neni, është paraparë se: *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënie të përgjigjes në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”.*

Në rastin konkret dhe në kuptim të dispozitës së cekur më lartë, rezulton se themelësia e kërkesëpadisë së paditëses del nga faktet e treguara në padi dhe nga provat që i janë bashkëngjitur padisë, pasi që nga Aktgjykimi penal i Gjykatës Themelore në Gjiilan P.nr.6/16, i datës 2.10.2017, i cili është bërë i plotfuqishëm nga data 13.11.2017, gjykata vërtetoi faktin se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-së nga shkak se i njejtë me qëllim që vetes ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që i ka lidhur direkt dy kablla, një trafazor dhe një monofazë me të cilën furnizohet me energji elektrike, me ç'rast ka bërë hargjim të energjisë elektrike në mënyrë të papautorizuar, duke e dëmtuar K...-in, këtu paditësen në shumë prej 269.43 €, e për të cilën vepër gjykata i ka shqiptuar dënim me kusht,

ndërsa të dëmtuarën K..., këtu paditëses për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest civil. Përveç të cekurave, gjykata nga fatura me nr. DGLHP04812, e datës 09.11.201, e lëshuar nga K..., ka vërtetuar faktin se në emër të rikthimit të humbjeve, i padituri ka qenë i obliguar që të bëjë pagesën e shënuar në këtë faturë në shumë prej 269.43 €, dhe si afat i pagesës së kësaj shume ka qenë data 09.11.201.

Si dispozitë materiale në këtë çështje kontestimore, gjykata ka zbatuar dispoziten e nenit 136 dhe 24 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (në vijim: LMD), për shkak se, me dispozitën e nenit 136 para. 1 të këtij ligji, është paraparë se: *“Kush i shkaktton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa me dispozitën e nenit 24, para. 1 të po këtij ligji, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndëgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Po ashtu sa i përket vendosjes për kamatën e gjykuar, gjykata ka zabatur dispozitën e nenit 382 të po këtij ligji, pasi që me këtë nen, shprehimisht është paraparë se: *“Debitori që vonon përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën. Lartësia e kamatës është (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Po ashtu, sipas nenit 14 të LPK-së është paraparë se: *“Në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Duke pas parasysh faktin se janë plotësuar kushteve ligjore sipas nenit 10 të LPK-së për të vendosur me aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, gjykata në bazë të cekurave më lartë, vlerëson se meqë themelësia e kërkesëpadsisë së paditëses del nga provat e lartëcekura, e në zbatim të dispozitave materiale të cekura më lartë, vendosi që të paditurën ta detyroj që paditëses t’ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 269.43 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8 % prej datës së paraqitjes së padisë me 04.11.2020 e deri në pagesën definitive.

Gjykata në bazë të dispozitës së nenit 463.2 të LPK-së ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse, me këtë dispozite është përcaktuar qartë se: *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po qe se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*. Më rastin konkret paditësja në padi i kërkuar shpenzimet e procedurës, por e njëjta nuk i ka specifikuar shpenzimet, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 463.2 të LPK-së, gjykata nga kjo arsye e ka refuzuar kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Nga se u tha më lartë, e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr.212/2020, me dt. 02.04.2021

Gjyqtari,

Numri i lëndës: 2020:151026
Datë: 02.04.2021
Numri i dokumentit: 01662954

Blerim BESHTICA

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.